



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Prishtinë, 25 tetor 2019

Komunikatë

Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës – PZAP, në seancën e mbajtur më datë 25.10.2019, ka shqyrtuar ankesën: Anr.378/2019, e paraqitur nga subjektit politik Koalicioni NISMA-AKR-PD, të datës 24.10.2019, me të cilën kanë kërkuar nga PZAP-i që të aprovoj ankesën e këtij subjekti dhe të Urdhërohet KQZ-ja, që të anulohet përjashtoj nga rezultatit i numërimit në tersi grumbullin e fletëvotimeve të ardhura nga Serbia.

Dhe ankesën: Anr.377/2019, e datës 23.10.2019, e parashtruar nga Veton Berisha – Kryetar i Partisë Liberale Egjiptiane (PLE), paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me anë të së cilës ka kërkuar, që të urdhëroj KQZ-në për rinumërim të 198 vendvotimeve, të cilat nuk kanë qenë të përfshira në rinumërimin nga ana e KQZ-së, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të datës 06.10.2019.

Te dy ankesat janë hudhur të palejuara.

Për më tepër informata ju mund keni qasja në ueb faqe dhe faqen në facebook të PZAP-it për vendimet e PZAP-it Anr.378/2019 të datës 25.10.2019 dhe Anr.377/2019, e datës 25.10.2019